



Datë: 30.09.2025

Numër Protokolli: 6465/2025

A.nr.1533/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës me numër A.nr.1533/2025, të datës 04.08.2025, të parashtruar nga ankuesja T.B, nga Prishtina, kundër Zyrës së Presidentes, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafi, 1.1 dhe nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 30.09.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.1533/2025, e datës 04.08.2025, e parashtruar nga ankuesja T.B.

II. Anulohet në tersi procedura e pranimit sipas konkursit me Nr. Reference: RN00017639 për pozitën e punës “*Udhëheqës i Divizionit për Marrëdhënie me Publikun*”, i shpallur nga Zyra e Presidentes së Kosovës, si dhe çdo veprim apo akt tjetër që ka rrjedhë nga kjo procedurë e rekrutimit.

III. Obligohet Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Zyrës së Presidentes së Kosovës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij, duke ndërmarr të gjitha veprimet si në pikën II të dispozitivit.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.

A r s y e t i m

Kandidatja në procedurë, T.B (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), me datë 04.08.2025, ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit për kandidatin fitues të datës 08.07.2025, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, në konkursin me Nr. Reference RN00017639, për pozitën “*Udhëheqës i Divizionit për Marrëdhënie me Publikun*”, Zyra e Presidentes së Kosovës, (tani e tutje referuar Zyra e Presidentes).

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 13.08.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Zyra e Presidentes, ndërsa kjo e fundit me datë 19.08.2025 dhe 22.09.2025, ka dorëzuar përgjigjet në ankesë se bashku me shkresat e lëndës.

Kryetari i Këshillit, me datë 17.09.2025 ka nxjerrë Vendimin me shifër VK/2025 dhe numër protokolli: 6204/2025, përmes të cilit ankesës së ankueses nën shenjë A.nr.1533/2025 të datës 04.08.2025 ia ka vazhduara afatin e vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë të tjera, ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 5214/2025 të datës 04.08.2025 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen e ID-së së ankueses; Vendimin e Kryetarit të Këshillit të datës 17.09.2025; Konkursin RN00017639 të datës 16.04.2025; Formularin e renditjes përfundimtare të datës 08.07.2025; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 13.08.2025; Përgjigje në kërkesë e datës 19.08.2025; Kërkesë për aprovimin e fillimit të procedurës së rekrutimit e datës 14.04.2025; Listën e aplikantëve; Njoftimin e datës 30.05.2025; Njoftimin e kandidatëve të suksesshëm të datës 08.07.2025; Vendimin e datës 09.06.2025 të UD. Sekretarit të Zyrës së Presidentes; Vendimin e datës 13.06.2025 të UD. Sekretarit të Zyrës së Presidentes me akt emërimet e anëtarëve të Komisionit të Pranimit; Aplikacionin e ankueses të datës 04.05.2025 me dokumentacionin e bashkangjitur; Kërkesën e datës 16.09.2025; Përgjigjen e datës 22.09.2025; Vendimin Nr.prot:1337 të datës 16.12.2020 të Presidentes së Republikës së Kosovës.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së ankesa e ankueses **është e bazuar**, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit, ka konstatuar se Zyra e Presidentes, më datë 07.04.2025 ka shpallur konkursin me Nr. Reference: RN00017639, për pozitën e punës “Udhëheqës i Divizionit për Marrëdhënie me Publikun”, me afati aplikimi nga data 17.04.2025 deri më datë 16.05.2025.

Tutje, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesja, e cila e ka kaluar fazën e verifikimit paraprak dhe i është nënshtruar testit me shkrim të kësaj procedure rekrutimi dhe ka arritur të marr 50.2 pikë, të cilat ka qenë të mjaftueshme për të kaluar testin me shkrim nga 50 pikë sa është e nevojshme për të vazhduar në procedurën e rekrutimit, respektivisht intervistën me gojë, sikurse përcaktohet me dispozitat e aplikuara nga Udhëzim Administrativ (SZP) Nr. 02/2024 Për Procesin e Rekrutimit të Nëpunësve Civilë në Presidencë, neni 16 paragrafi 2 ku përcaktohet se: “2. Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim, kanë të drejtë të marrin pjesë në intervistë”, ndërsa në intervistën me gojë e njëjta ka marrë 21 pikë, kurse sipas listës përfundimtare të kandidatëve të suksesshëm, kandidati Sh.B është, renditur i pari në këtë listë me gjithsejtë 80.4 pikë të arritura, ndërsa ankuesja është renditur e katërta (4) me radhë me gjithsejtë 71.2 pikë të përgjithshme, ashtu që sipas Njoftimit të datës 08.07.2025 sipas renditjes përfundimtare të kandidatëve, të Divizioni të

Burimeve Njerëzore në organin përkatës të punësimit, rezulton se kandidat fitues është kandidati Sh.B i cila ka marr më shumë pikë, gjithsejtë 80.4 prej të cilave 59.4 në testin me shkrim, ndërsa 21 në intervistën me gojë.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshill kundër aktit përfundimtar të procedurës së rekrutimit në të cilën ka marrë pjesë, pretendon se vlerësimi i Eses nga ana e Komisionit të Pranimit nuk ka qenë i drejtë dhe profesional, si dhe me pretendimin ankimor se ka pasur mospërputhje mes kritereve të shpallura dhe mënyrës së zbatimit të tyre gjatë vlerësimit, me kërkesën që të shqyrtohen testet nga komisioni profesional apo të anulohet vlerësimi përfundimtar si dhe procesi i rekrutimit në tërësi duke e kthyer në pikën zero këtë proces.

Kolegji i Këshillit mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, fillimisht ka shqyrtuar veprimet e ndërmarra procedurale nga Zyrtari Kryesor Administrativ i Presidentes së Kosovës, respektivisht Sekretari i Zyrës së Presidentes dhe konstatoi se:

Aprovimin e fillimit të procedurës së rekrutimit për pozitën “*Udhëheqës i Divizionit për Marrëdhënie me Publikun*” me datë 14.04.2025 e ka dhënë Ushtruesi i Detyrës së Sekretarit të Zyrës së Presidentes, dhe po ashtu me datë 09.06.2025 përmes Vendimit Nr.02/11-733-01/25 i plotësuar dhe ndryshuar përmes Vendimit Nr.02/11-733-02/25 të datës 13.06.2025, Komisionin e Pranimit e ka themeluar Ushtruesi i Detyrës së Sekretarit të Zyrës së Presidentes.

Thënë si më lartë, Kolegji i Këshillit përmes përfaqësuesit të autorizuar me datë 16.09.2025 i është drejtuar Njësisë së Burimeve Njerëzore të Zyrës së Presidentes me kërkesën për prova dhe sqarime shtesë, si në vijim: “*Vendimin për caktimin e UD. Sekretarit të Zyrës së Presidentes, me konfirmimin se nga cila periudhë kohore apo nga cila datë pozita në fjalë ushtrohet me Ushtrues Detyre*”, ndërsa njësia përkatëse e burimeve njerëzore me datë 22.09.2025 në cilësi të provës material ka ofruar Vendimin Nr.prot:1337 të datës 16.12.2020, përmes të cilit konstatohet fakti se Presidentja e Republikës së Kosovës, e ka emëruar z. F.M, Ushtrues të Detyrës së Sekretarit të Zyrës së Presidentes, respektivisht Kolegji i Këshillit konstatoi faktin se pozita e Sekretarit të Zyrës së Presidentes, ushtrohet me ushtrues detyre që nga data 16.12.2020.

Pas konstatimit të dhënë si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi, Kolegji i Këshillit analizoi dhe mori përbazë dispozitat e aplikuara nga neni 1 dhe neni 2 paragrafi 1 dhe paragrafi 3, të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: “*1. Ky ligj ka për qëllim rregullimin e marrëdhënies së punës së zyrtares/it publik në institucionet e Republikës së Kosovës, përkatësisht përcaktimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë pranimin, klasifikimin e pozitave, ndryshimin, përfundimin e marrëdhënies së punës, të drejtat dhe detyrimet në raport me marrëdhënien e punës, si dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me marrëdhënien e punës së zyrtares/it publik në institucionet e Republikës së Kosovës. Neni 2 Fusha e zbatimit 1. Ky ligj zbatohet për zyrtaren/in publik në institucionin publik të Republikës së Kosovës. 3. Për nëpunëset/it në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese, ky ligj zbatohet për atë që nuk cenon pavarësinë e tyre funksionale dhe organizative të garantuar me Kushtetutë*”, ndërlidhur me nenin 6 paragrafi 4 i të njëjti ligj ku përcaktohet se: “*4. Të punësuarat/it e administratës në*

kuadër të sistemit të drejtësisë, Gjykatës Kushtetuese, Presidencës, Kuvendit të Republikës së Kosovës, si dhe institucioneve të pavarura kushtetuese janë nëpunës civil me status të veçantë, rregullimi i të cilëve bëhet me akt të veçantë” dhe mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit konstatoi se të punësuarit në Presidencën e Kosovës/Zyrën e Presidentes e kanë statusin e nëpunësit civil me status të veçantë, e për të cilët rregullimi i marrëdhënies së punës bëhet me akt të veçantë, rregullim ky që bie në pajtueshmëri me qëllimin e këtij ligji, ndërlidhur me paragrafin 3 të nenit 2 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik.

Kolegji i Këshillit, po ashtu analizoi dhe mori për bazë edhe dispozitat e Ligjit Nr.08/L-294 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 Për Zyrtarët Publik, nenin 2 dhe nenin 6 paragrafi 3, ku përcaktohet se: *“2. Fushëveprimi i këtij ligji është i njëjtë me fushën e veprimit të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë; 6.3. Të punësuarit e administratës në kuadër të sistemit të drejtësisë, Gjykatës Kushtetuese, Presidencës, Kuvendit të Republikës së Kosovës, institucioneve të pavarura kushtetuese dhe agjencive të pavarura janë nëpunës civilë me status të veçantë, rregullimi i të cilëve bëhet me akt të veçantë”, nga rrjedh se çështjet përkatëse të përcaktuara dhe të trajtuara si më lartë nga Ligji Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, kanë mbetur të pa ndryshuara edhe nga Ligji përkatës për Zyrtarët Publik NR.08/L-294, që ndërlidhet me statusin e veçantë të nëpunësit civil në kuadër të Zyrës së Presidentes.*

Kolegji i Këshillit duke pasur parasysh ligjin e aplikuar material për shërbimin civil, në frymën e normave të përcaktuara si më lartë, mori për bazë dispozitat e Ligjit Nr.03/L-094 Për Presidentin Republikës së Kosovës, nenin 15 paragrafi 1 dhe neni 16 paragrafi 1, ku përcaktohet se: *“15.1. Sekretari është zyrtari kryesor administrativ dhe udhëheqës i stafit civil në Zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës; 16.1. Për zgjedhjen e Sekretarit të Zyrës së Presidentit shpallet konkurs sipas Ligjit mbi Shërbimin Civil të Kosovës”, po ashtu Kolegji i Këshillit mori për bazë edhe dispozitat e aplikuar nga neni 23 të Rregullores (P) Nr. 02/2022 Për Organizimin dhe Funksionimin e Presidencës ku përcaktohet se: “Sekretari është zyrtari kryesor administrativ dhe kompetencat i ushtron në pajtim me Ligjin për Presidentin dhe legjislacionin tjetër përkatës në fuqi” dhe po ashtu Kolegji i Këshillit mori për bazë edhe Rregulloren (P) Nr. 01/2025 Për Procesin e Rekrutimit të Sekretares/it të Zyrës së Presidentes/it nenin 19 ku përcaktohet se: “Emërimi në pozitën e Sekretarit, bëhet për një kohëzgjatje katër (4) vjeçare me të drejtë vazhdimi, për të njëjtën pozitë pune, vetëm edhe një (1) herë dhe për të njëjtën kohëzgjatje”, si dhe Udhëzimin Administrativ (SZP) Nr. 03/2024 Për Klasifikimin e Pozitave në Shërbimin Civil në Presidencë, nenin 2 ku përcaktohet se: “Ky Udhëzim Administrativ zbatohet për të gjithë nëpunësit e shërbimit civil në Presidencë.”, dhe mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit erdhi në konstatimin se Presidenca e Kosovës nuk e ka të trajtuar ndryshe çështjen ushtruesit të detyrës, respektivisht nuk e ka rregulluar ndryshe ushtrimin e një pozite drejtuese me ushtrues detyre, nga rrjedh se në rrethanat e rastit konkret gjejnë zbatim dispozitat e aplikuar nga neni 35 paragrafi Ligji Nr.08/L-197 Për Zyrtarët Publik, pasi që veprimet procedurale dhe konstatimet e dhëna janë rrethana të cilat kanë ndodhur me herët se data 17.06.2025, kur ka hyrë në fuqi Ligji Nr. 08/L-294 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 Për Zyrtarët Publik.*

Mbi bazën e konstatimeve të dhëna si më lartë Kolegji i Këshillit thekson faktin Ligji Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, i cili ka hyrë në fuqi nga data 25 shtator 2023, dhe si pasojë më hyrjen në fuqi të këtij ligji, marrëdhënia e punës e në veçanti çështjet lidhur me caktimin e ushtruesit të detyrës në shërbim civil duhet të behën në pajtim me dispozitat e nenit 35 të kij ligj, e më të cilat dispozita është përcaktuar se : *1.Në rast se një pozitë e nivelit drejtues brenda strukturës organizative të institucionit mbetet e lirë,*

nëpunësja/i i nivelit të lartë drejtues e atij institucioni e cakton me vendim ushtruesen/in e detyrës për pozitën e lirë ë pajtim me paragrafin 1. të këtij neni, ushtruesja/i i detyrës mund të caktohet zyrtarja/imë i lartë i kategorisë pasuese, në vartësi të pozitës që caktohet, nga cilado njësi organizative brenda institucionit. 3. Zyrtarja/i publik nuk mund të caktohet si ushtruese/i detyre më gjatë se gjashtë (6) muaj. Kur pozita nuk mund të plotësohet brenda afatit gjashtë (6) muaj, ky afat mund të zgjas më së shumti edhe për gjashtë (6) muaj të tjerë. 4. Pozita e lirë nuk mund të zëvendësohet me ushtrues detyre për më gjatë se afati i përcaktuar në paragrafin 3. të këtij neni. 5. Çdo vendim i marrë nga ushtruesja/i i detyrës, pas kalimit të afatit të përcaktuar në paragrafin 3. të këtij neni, është i paligjshëm” , andaj, duke qenë se me hyrjen në fuqi të këtij ligji pozita e Sekretarit të Zyrës së Presidentes ka qenë e lirë dhe e njëjta ka qenë duke u ushtruar me ushtrues detyre, respektivisht me datë 16.12.2020 përmes Vendimit Nr.prot:1337 Presidentja e Republikës së Kosovës, e ka emëruar z. F.M, Ushtrues të Detyrës së Sekretarit të Zyrës së Presidentes, dhe mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit ka arritur të konstatoi se pozita e Sekretarit të Zyrës së Presidentes, është mbuluar me ushtrues detyre në një periudhë prej më shumë se katër (4) vitesh, ndërsa pas hyrjes në fuqi të Ligji Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, që nga data 25 shtator 2023 e njëjta pozitë ka qenë duke u ushtruar me ushtrues detyre prej më shumë se (1) një viti, respektivisht prej një (1) viti e nëntë (9) muajsh, deri në momentin e nxjerrjes së vendimit për themelimin e Komisionit të Pranimit, dhe mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit, konstaton se pozita e Sekretarit të Zyrës së Presidentes, pas datës 25.09.2024 ka qenë duke u ushtruar me ushtrues detyrë në kundërshtim me nenin 35 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë.

Duke qenë se sipas dispozitave të cekura më lartë një pozitë drejtuese nuk mund të mbahej me ushtrues detyrë më gjatë se një vit, atëherë më datë 25.09.2024, ka kaluar afati prej një viti (1) i ushtruesit të detyrës së pozitës së Sekretarit të Zyrës së Presidentes, kështu që në kuadër të kësaj Kolegji i Këshillit, konstaton se çdo vendim i marrë nga ushtruesja/i i/e detyrës, pas kalimit të afatit prej një viti është i paligjshëm, atëherë në këtë kontekst aprovimi i shpalljes së konkursit i dhënë përmes shkresës së datës 14.04.2025, si dhe nxjerrja e Vendimit Nr.02/11-733-01/25 të datës 09.06.2025 i plotësuar dhe ndryshuar me Vendimin Nr.02/11-733-02/25 të datës 13.06.2025 për themelimin e Komisionit të Pranimit, janë të akte të paligjshme sepse janë aprovuar respektivisht nxjerr nga zyrtari në cilësi të ushtruesit të detyrës Sekretarit të Zyrës së Presidentes, pozitë kjo që është ushtruar në mënyrë të kundërligjshme nga data 25.09.2024 e deri në aprovimin e shpalljes dhe themelimit të komisionit të pranimit që ndërlidhet me rrethanat e rastit konkret të kësaj procedura rekrutimi.

Lidhur me konstatimet e dhëna si më lart, Kolegji i Këshillit mori për bazë edhe konstatimet e Gjykatës Supreme, të dhënë si në Aktgjykimin P.A.nr.07/2025, të datës 10.06.2025, ku nder të tjera Gjykata Supreme ka konfirmuar se: *...Nga kjo dispozitë rrjedh qartë se çdo akt juridik i nxjerrë nga një udhëheqës në cilësinë e ushtruesit të detyrës pas skadimit të afatit prej një viti është i pavlefshëm në thelb, për shkak të mungesës së kompetencës ligjore për të ushtruar funksionet që burojnë nga ajo pozitë..... Ligji i referohet pozitës si funksion institucional dhe jo individit si person. Pra, ndërrimi i personit nuk e ndërpret dhe nuk e rifillon afatin gjashtë muaj, përkatësisht njëvjeçar të ushtrimit të përkohshëm të pozitës. Kjo qasje është në përputhje me frymën e ligjit që kërkon stabilitet, profesionalizëm dhe përgjegjësi institucionale në udhëheqjen publike.*

Në mbështetje të konstatimit të dhënë si më lartë, gjegjësisht, duke qenë se aprovimi i shpalljes së procedurës së rekrutimit dhe emërimi i Komisionit të Pranimi nuk ka qenë në pajtim me kërkesat ligjore, atëherë Kolegji i Këshillit rithekson faktin se institucionet e administratës publike janë të obliguara ta zbatojnë Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, respektivisht dispozitat e nenit 4, ku përcaktohet se: *“1. Organet publike veprojnë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si edhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilat janë dhënë këto kompetenca. 2. Veprimi administrativ që cenon apo mund të cenojë një të drejtë apo interes juridik të një personi, duhet të jetë i autorizuar nga një ligj”, e në këtë rast ushtrues i detyrës së Sekretarit të Zyrës së Presidentes, ka vepruar pa kompetencë, andaj edhe procedura e pranimi sipas konkursit me Nr. Reference: RN00017639, për pozitën e punës “Udhëheqës i Divizionit për Marrëdhënie me Publikun”, të shpallur nga Zyra e Presidentes së Kosovës, është e paligjshme në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.2, 1.3, 1.5 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: 1. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.1. është nxjerre në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij Ligji; 1.2. organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë; 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material; 1.6. është rezultat i diskrecionit që është ushtruar në mënyrë jo të ligjshme, andaj Kolegji i Këshillit, konstaton se sipas këtyre rrethanave, vendosi të aprovojë ankesën e ankueses, të anuloj në tërësi procedurën e pranimi sipas konkursit me Nr. Reference: RN00017639, dhe si rrjedhojë çdo veprim apo akt tjetër administrativ e ndërmarr nga kjo procedurë e rekrutimit, ndërsa në pajtim me dispozitivin dhe arsyetimin e këtij vendimi Njësia e Burimeve Njerëzore e Zyrës së Presidentes është e obliguar të publikoi njoftimin për anulimin e konkursit përkatës sipas vendimmarrjes nga ana e Këshillit, e përcaktuar në pikën II dhe III të dispozitivit të këtij Vendimi.*

Prandaj përkitazi me konstatimet e dhëna si më lartë, Kolegji i Këshillit thekson faktin se nuk u lëshua në shqyrtimin e pretendimeve të tjera ankimore të ankueses, ngase nuk do të ndryshonte natyrën e vendimmarrjes të përcaktuar si në këtë vendim, respektivisht ankesa e ankueses është aprovuar vetëm mbi bazën e konstatimeve të dhëna si më lartë.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.1533/2025, datë 30/09/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses T.B;
- Njesisë së Burimeve Njerëzore në Zyrën e Presidentes së Kosovës, si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

